

DASHURIA E
PERËNDISË



DR.
CHARLES
SERITË THEMELET FRYMËRORE
STANLEY
INTOUCH MINISTRIES

Të drejtat e autorit © nga Dr. Charles Stanley

Seritë Themelet Frymërore

Botuar nga Shërbesa “Prekja e Zotit”, Atlanta, Georgia, 30340

Përveçse nëse përmendet ndryshe, Shkrimet janë marrë nga NEW AMERICAN STANDARD BIBLE, Të drejtat e autorit ©1960, 1962, 1963, 1968, 1971, 1972, 1973, 1975, 1977, 1995 nga The Lockman Foundation. Përdorur me leje. (www.Lockman.org).

Shkrimet me shënimin (TLB) janë marrë nga The Living Bible Të drejtat e autorit © 1971. Përdorur me lejen e Tyndale House Publishers, Inc., Wheaton, IL 60189. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Shkrimet me shënimin (NIV) janë marrë nga HOLY BIBLE NEW INTERNATIONAL VERSION, NIV. Të drejtat e autorit © 1973, 1978, 1984 nga Biblica, Inc.

Përdorur me lejen e Zondervan. Të gjitha të drejtat e rezervuara anëmbanë botës. www.zondervan.com.

“NIV” dhe “New International Version” janë marka të regjistruara në Zyrën e Markave dhe Patentave të Shteteve të Bashkuara nga Biblica, Inc.

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në një sistem përtëritës ose të transmetohet në ndonjë formë ose mënyrë – elektronike, mekanike, fotokopje, regjistrim ose çfarëdolloj mënyre tjetër – pa lejen paraprake të botuesit.

Citimet nga Bibla janë marrë nga versioni “Diodati i Ri”
(1991-1994)

© SHOQËRIA BIBLIKE SHQIPTARE (ABS) TIRANË

Përdorur me leje.

Përgatiti për shtyp, “Radio 7”

DASHURIA E PERËNDISË

JU KENI LINDUR PËR TË DASHUR DHE PËR TË QENË TË DASHUR NGA TË TJERËT

Qëllimi i jetës tuaj shkon përtej sigurimit të jetesës, kujdesit për familjen ose mbijetesës së përditshme. Ju jeni krijuar nga Perëndia për të pasur një marrëdhënie të drejtpërdrejtë e përmbushëse me Të dhe për ta përçuar dashurinë e Tij tek të tjerët. Në një botë komplekse, të mbushur me dhimbje dhe probleme sociale të ndërlikuara, deklarimi i këtij qëllimi mund të duket naiv, por në fakt nuk është.

Një herë, një njohës shumë i mirë i ligjit, i bëri një pyetje shumë të rëndësishme Jezusit:

“Mësues, cili është urdhërimi i madh i ligjit?”.

“Dhe Jezusi i tha: “DUAJE ZOTIN, PERËNDINË TËNDE ME GJITHË ZEMRËN TËNDE, ME GJITHË SHPIRTIN TËND DHE ME GJITHË MENDJEN TËNDE.”. Ky është urdhërimi i parë dhe i madhi. Dhe i dyti, i ngjashëm me këtë, është: “DUAJE TË AFËRMIN TËND PORSI VETVETEN.”. Nga këto dy urdhërime varet i tërë ligji dhe profetët.” (Mateu 22:36-40).

Njerëzit në kohën e Jezusit, veçanërisht mësuesit dhe njohësit e ligjit, ishin po aq të shqetësuar për t'i shkuar gjërave deri në fund, sa jemi ne sot. Kush është thelbi i jetës? Cila është gjëja më e rëndësishme? Përgjigja e Jezusit është shumë e qartë: thelbi i ekzistencës së njerëzimit është dashuria.

Perëndia ju ka dashur që nga çasti kur jeni ngjizur, madje edhe përpara se kjo të ndodhte. (Efesianëve 1:3-6) Ai ju formoi, në barkun e nënës tuaj, nerv pas nervi, qelizë pas qelize, duke ju dhënë trajtë me shumë kujdes si një kryevepër e papërsëritshme. Psalmi 139:15-16 përshkruan vëmendjen e Perëndisë gjatë formimit tuaj:

“Kockat e mia nuk ishin një e fshehtë për ty kur u formova në fshehtësi duke u endur në thellësitë e tokës. Dhe sytë e tu panë masën pa trajtë të trupit tim, dhe në librin tënd ishin shkruar ditët që ishin caktuar për mua, megjithëse asnjë prej tyre nuk ekzistonte ende.”.

Perëndia ju njeh shumë mirë, madje edhe më mirë nga sa e njihni ju veten dhe Ai do që edhe ju ta njihni dhe ta doni Atë në të njëjtën mënyrë.

Qëllimi i Perëndisë për jetën tuaj është që ju ta njihni Atë si të vetmin Perëndi të vërtetë. Duke e njohur Atë, ju filloni ta adhuroni dhe t'i shërbeni Atij, ta lavdëroni dhe ta nderoni të Dashurin e zemrës me fjalët dhe jetën tuaj.

Perëndia nuk kishte arsye që ju krijoi; Ai nuk ka “nevojë” për ju ashtu siç ju keni nevojë për bukë, ujë apo shoqëri. Perëndia është i plotë dhe nuk i mungon asgjë, por Ai zgjodhi t’ju krijojë. Ai zgjodhi t’ju sillte në jetë për t’ju falur dashurinë e Tij hyjnore dhe për të marrë mbrapsht dashurinë tuaj. Kjo miqësi është shumë e rëndësishme për Perëndinë

SHUMË FYTYRAT E DASHURISË

Kur filloni të mendoni për dashurinë, skena të shumta ju kalojnë nëpër mendje: një nënë që shtrëngon foshnjën e saj me dhembshuri, një çift që shëtit përgjatë bregut të detit, fëmijë që luajnë, miq të vjetër që takohen, një infermiere që kujdeset për një pacient. Fjala “dashuri” përmbledh një mori marrëdhëniesh dhe ndryshon në intensitet në varësi të përdorimit të saj.

Për këtë arsye është shumë e rëndësishme që të përcaktojmë me saktësi se çfarë kuptojmë me fjalën dashuri para se të flasim për dashurinë që Perëndia ka për ne. Në greqisht, gjuha në të cilën u shkrua Dhjata e Re, ka shumë fjalë për dashurinë. “Phileo” do të thotë dashuri vëllazërore, një ndjenjë që ekziston midis anëtarëve të një familjeje ose midis miqve. “Eros” i referohet dashurisë romantike ose seksuale. Ndërsa fjala që i referohet dashurisë së Perëndisë është “agape”, që dallon tërësisht nga fjalët e përdorura për të përshkruar marrëdhëniet njerëzore.

Dashuria agape është dashuria e përsosur, konsumuese, e pamasë, e pakushtëzuar e Perëndisë. Ajo është tërësisht altruiste, falëse dhe e përkushtuar ndaj mirëqenies tuaj të plotë. Ju vetë nuk mund ta përjetoni ose të falni dashuri agape; ajo vjen vetëm nga Perëndia. Nëse përpiqeni të mendoni për veprën më bujare ose dashamirëse që një qenie njerëzore ka mundur të kryejë, as ajo nuk mund të krahasohet me madhësinë e dashurisë së përjetshme, të patundshme që Perëndia ka për ju.

Pesë herë në Dhjatën e Vjetër, Perëndia është quajtur Perëndi xheloz. Kur izraelitët filluan të binin përmbys përpara idhujve, Moisiu u kujtoi urdhërimin e dytë nga Dhjetë Urdhërimet:

“Ruhuni se harroni besëlidhjen që Zoti, Perëndia juaj, ka lidhur me ju, dhe bëni ndonjë shëmbëlltysë të gdhendur në trajtën e çfarëdo gjëje që Zoti, Perëndia yt, e ka ndaluar. Sepse Zoti, Perëndia yt, është një zjarr që konsumon, një Zot ziliqar.” (Ligji i Përtërirë 4:23-24).

Kjo nuk do të thotë se Perëndia është zemërngushtë ose egoist, që do t’ju ketë të gjithëve për Vete, ashtu siç janë xheloz njerëzit. Perëndia thjesht nuk do që ju t’i kushtoni vëmendje dhe të adhuroni me zemrën tuaj askënd tjetër, sepse Ai ju do jashtëzakonisht shumë dhe ju projektoi në mënyrë të tillë që të gjeni përmbushje të plotë vetëm në marrëdhënien me Të. Askush

dhe asgjë nuk mund ta plotësojë dëshirën e zjarrtë që Perëndia vendosi brenda jush. Dhënia e përparësisë çfarëdolloj gjëje tjetër para Perëndisë ju vjedh si ju ashtu edhe Atë.

Dashuria agape e Perëndisë nuk shteron kurrë; ajo nuk është e paqëndrueshme, nuk venitet, nuk ndryshon as nuk është kapriçoze. Tek Jeremia 31:3 thuhet: “të kam dashur me një dashuri të përjetshme; prandaj të kam tërhequr me dashamirësi.”. Ndjenjat tona mund të ndryshojnë dita-ditës, bazuar në luhatjet e humorit, gjendjen shëndetësore ose shumë faktorë të tjerë. Ndërsa Jezus Krishti është i njëjtë dje, sot e përjetë (Hebrenjve 13:8). Prandaj dashuria e Tij është e pandryshueshme.

PERËNDIA E LEXON DASHURINË KËSHTU: S-A-K-R-I-F-I-C-E

Ndoshta ju keni dëgjuar për njerëz që kanë vënë në rrezik jetën e tyre për të shpëtuar të tjerët, nga zjarri ose përplasja. Në një moment kritik, ata nuk e kanë marrë parasysh sigurinë dhe të ardhmen e tyre për t’ju dhënë të tjerëve një mundësi për të jetuar. Histori të tilla të bëjnë të thuash: “Epo kjo është dashuri!”.

Jezusi tha diçka të ngjashme tek Gjoni 15:13: “Askush s’ka dashuri më të madhe nga kjo: të japë jetën e vet për miqtë e tij.”.

Këtë lloj dashurie shpërfaqti edhe Jezusi kur erdhi në tokë të vdiste për mëkatet tuaja. Ai hoqi dorë nga gjithçka për një farë kohe në vendin tuaj, duke e lënë mënjanë nderin dhe lavdinë që i përkasin për t'u bërë njeri – Perëndia në mish, tërësisht Perëndi dhe tërësisht njeri (Gjoni 1:1, 14).

Letra e Filipianëve përshkruan sakrificën e tij personale të pakapshme nga mendjet tona:

“Edhe pse ishte në trajtë Perëndie, nuk e çmoi si një gjë ku të mbahej fort për të qenë barabar me Perëndinë, por e zbrazi veten e tij, duke marrë trajtë shërbëtori, e u bë i ngjashëm me njerëzit; dhe duke u gjetur nga pamja e jashtme posi njeri, e përuli vetveten duke u bërë i bindur deri në vdekje, deri në vdekje të kryqit.” (Filipianëve 2:6-8).

Përse e bëri një sakrificë kaq të madhe Jezusi për ju? Ai e bëri për t'ju çliruar nga e vetmja gjë që ju ndan nga dashuria e Perëndisë – mëkati. Çdo gjë që është e papëlqyeshme për Perëndinë dhe bie në kundërshtim me ligjin e Tij, Perëndia e quan mëkat dhe ne të gjithë jemi mbartës të mëkatit në zemrat tona qysh në lindje (Romakëve 3:23).

Mëkati është barriera e madhe e dashurisë dhe vetëm dikush që është i pamëkatë mund ta largojë atë prej jush. Ky dikush është Jezus Krishti, Biri i patëmetë i Perëndisë. Ai mori mbi veten ndëshkimin në vendin tuaj. Nëse

besoni në atë që Ai bëri dhe e vendosni besimin tuaj tek Ai si Shpëtimtari juaj, Ai fshin çdo grimcë faji dhe çdo gjë të keqe që ju keni bërë. (Gjoni 3:16; 13:1; Romakëve 8:1; 1 Gjonit 4:9-10) Ju mbuloheni me dashurinë e Tij dhe vazhdoni të jetoni në të përjetë.

Të kuptuarit e dashurisë së Tij absolute, të pakushtëzuar është i rëndësishëm për të pasur një marrëdhënie të lirë dhe të qëndrueshme me Të. Nëse jeni të shqetësuar se mos e humbisni ose nuk jeni të sigurt që e keni, ju nuk mund të pushoni dhe të banoni në Krishtin në mënyrën që Ai do, duke e lejuar Atë që të ketë kontroll mbi jetën tuaj. Ankthi në lidhje me dashurinë që Ai ka për ju është shkak kryesor i dëshpërimit frymëror për shumë besimtarë dhe është i panevojshëm.

Sakrifica e Jezusit është pjesë e dashurisë agape të Perëndisë; ju nuk mund ta humbisni favorin ose dashurinë e Perëndisë si pasojë e diçkaje që thoni, bëni apo mendoni. Për këtë na garanton Efesianëve 2:8-9:

“Ju në fakt, jeni të shpëtuar me anë të hirit; nëpërmjet besimit, dhe kjo nuk vjen nga ju, po është dhurata e Perëndisë, jo nga vepra që të mos mburret askush.”.

Nuk është e nevojshme që ju të kryeni veprime të caktuara për të fituar dashurinë e Tij (Romakëve 5:8). Perëndia ju do dhe Ai nuk ndërron kurrë mendje, pavarësisht gjithçkaje.

T'I THUASH PERËNDISË: "EDHE UNË TË DUA"

Ndërsa ndjeni dashurinë e Tij tek sa ju rrethon, duke e mbështjellë gjithë qenien tuaj me ngrohtësi hyjnore dhe përkujdesje pafund, edhe juve ju vjen natyrshëm ta doni. Mirënjohja, adhurimi, afrimiteti, respekti, dashuria, nderimi, ndjeshmëria – të gjitha këto ndjenja e shumë të tjera lindin brenda jush, duke ju bërë të gëzoheni për marrëdhënien me Të.

Adhurimi është një nga mënyrat për t'i dhënë lavdi Zotit. Qoftë në publik apo privatisht, ju mund të këndonit, luteni, studioni Fjalën e Tij ose të inkurajoheni nga besimtarë të tjerë duke u mbledhur së bashku. Sado i rëndësishëm të jetë adhurimi për marrëdhënien tuaj me Perëndinë, Ai ju thërret në një shprehje dashurie që e tejkalon këtë kategori. Perëndia i thërret fëmijët e Tij ta kthejnë bindjen në një stil jetese.

Jezusi bëri lidhjen midis dashurisë dhe bindjes tek Gjoni 14:23-24, kur po u tregonte dishepujve se si do të ishte jeta pasi Ai të largohej prej tyre për t'u kthyer në qiell:

“Nëse ndokush më do, do ta zbatojë fjalën time; edhe Ati im do ta dojë dhe ne do të vijmë tek ai dhe do të bëjmë banesën tek ai. Kush nuk më do, nuk i zbaton fjalët e mia; dhe fjala që po dëgjoni nuk është imja, por e Atit që më ka dërguar.”

Mënyra se si veproni me Fjalën e Perëndisë, se sa shumë vëmendje i kushtoni porosive dhe urdhërimeve të Tij, flet shumë për dashurinë që keni për Të. Jezusi nuk tha se nëse nuk i bindeni Perëndisë, nuk do t'i përkisni më Atij. Pasi Ai bëhet Shpëtimtari juaj, ju jeni përgjithmonë të Tijtë, pavarësisht sjelljes tuaj. Bindja nuk është masë vlerësimi e sjelljes, por tregues i prioritetit.

Imagjinoni një baba dhe një vajzë të vogël. Babai i thotë të pastrojë dhomën e saj, por vajza mendon se ka gjëra më të mira për të bërë dhe vendos të mos i bindet urdhrave të tij. Duke vepruar në këtë mënyrë, ajo manifeston mungesë respekti e madje edhe pak egoizëm duke zgjedhur të plotësojë dëshirat e saj momentale para porosive të të atit. Ajo është përsëri vajza e tij dhe ai vazhdon ta dojë akoma shumë, por në marrëdhënien e tyre ka një problem. Për të pasur harmoni të vërtetë dhe shkëmbim afeksioni të pastër, vajza duhet të mësojë mënyrën më të mirë se si ta bëjë të lumtur të atin dhe kjo është duke bërë atë që ai i thotë.

Ndërsa Jezusi ju rrit në besim dhe rrënjos parimet e Tij në jetën tuaj, ju digjeni nga dëshira për të bërë atë që i pëlqen. Ju ka shkuar ndonjëherë nëpër mend se Perëndia ka ndjenja? Perëndia nuk ka “ndjenja të gabuara” me dobësi e të meta si tonat, por Ai është krijuesi i tyre. Kur ju anashkaloni atë që Ai thotë, Perëndia preket nga vendimi juaj. Tek Efesianëve 4:30 thuhet: “Dhe mos e

trishtoni Frymën e Shenjtë të Perëndisë, me të cilin u vulosët për ditën e shpengimit.”.

Ju duhet të kuptoni se urdhërimet e Perëndisë janë të mira. Drejtimi i Tij është gjithmonë në interesin tonë më të mirë (Mateu 7:7-11). Shumë nga urdhërimet e Tij, sidomos ato që bëjnë pjesë tek Dhjetë Urdhërimet janë për sigurinë tuaj (Eksodi 20). Një psalmit në Dhjatën e Vjetër e kuptoi lidhjen midis gëzimit të vërtetë dhe bindjes ndaj urdhërimeve të Perëndisë. Himni i lëvdimit të tij tek Psalmi 119 është i mbushur me nderim për urtësinë e Perëndisë në hartimin e këshillave morale për të na mbrojtur nga efektet e mundshme shkatërruese të mëkatit. Ai shkruan:

“Lum ata që kanë një rrugë pa njollë dhe që ecin me ligjin e Zotit. Lum ata që respektojnë mësimet e tij, që e kërkojnë me gjithë zemër. . . . Do të të kremtoj me zemër të drejtë ndërsa mësoj dekretet e tua të drejta. . . . Mbamë larg nga gënjeshtria dhe, në hirin tënd, bëmë të njohur ligjin tënd. Kam zgjedhur rrugën e besnikërisë; i kam vënë dekretet e tua para vetes. Jam i lidhur me porositë e tua; o Zot, mos lejo që unë të hutohem. Do të veproj në rrugën e urdhërimeve të tua, sepse ti do të më zgjerosh zemrën.” (Psalmi 119:1-2, 7, 29-32).

Bindja nuk është diçka mekanike, një punë e rëndë; ajo është çelësi drejt lirisë së vërtetë, të perëndishme që nuk njih kufij.

BËHU PËRÇUES I DASHURISË

Bota është e uritur për dashuri. Nuk ka nevojë për sondazhe apo studime për të kuptuar se një nga shkaqet kryesore të shumë sëmundjeve shoqërore është mungesa e dashurisë së pastër. Për ata që nuk e njohin dashurinë e Perëndisë, zbrazëtira në zemrat e tyre i bren vazhdimisht, pavarësisht nëse janë të vetëdijshëm apo jo për të. Shumë përpiqen ta mbushin atë me argëtime dhe varësi të panumërta, ndërsa të tjerë thjesht përpiqen të tërheqin vëmendjen ose të përfitojnë nga afeksionet që u fal momenti.

Kur vjen fjala tek ndarja e dashurisë së Perëndisë me të tjerët, personat që kanë nevojë për të janë të shumtë; kjo është arsyeja përse duhet ta merrni shumë seriozisht rolin tuaj si përçues të dashurisë së Tij. Tek Letra e Dytë e Korintasve 1:3-4 thuhet:

“Bekuar qoftë Perëndia dhe Ati i Zotit tonë Jezu Krisht, Ati i të mëshirëve dhe Perëndia e çdo ngushëllimi, i cili na ngushëllon në çdo shtrëngim tonin, që, nëpërmjet ngushëllimit me të cilin ne jemi ngushëlluar nga Perëndia, të mund të ngushëllojmë ata që janë në çfarëdo shtrëngimi.”.

Me një Mik dhe Shpëtimtar që kujdeset për çdo nevojë tuajën dhe e mbulon jetën tuaj me premtimin e Tij të kujdesit të përjetshëm, ju keni në dispozicion gjithçka që ju duhet. Në vështirësi, nën stres, në kohë pështjellimi,

ju keni marrëdhënie me të Vetmin Perëndi që ka përgjigjet dhe forcën për t'ju nxjerrë prej tyre. Tani ju keni mundësi ta ndani këtë dashuri me të tjerët. Ju jeni ambasadorë që mund të sillni ndryshimin; ju jeni kripa e tokës dhe drita e botës (2 Korintasve 5:20; Mateu 5:13-16).

Sigurisht, të mendosh në terma të përgjithshëm dhe jo konkretë se si “të ndihmosh të tjerët” dhe “të japësh dashuri” është e lehtë. Po çfarë nënkuptojnë ato? Kujt saktësisht duhet t'i tregoni dashuri? Si përgjigje ndaj përpjekjes së dikujt për ta vënë në provë me një pyetje të vështirë, Jezusi tregoi një shëmbëlltyrë në lidhje me këtë çështje shumë të rëndësishme:

“Një burrë zbriste nga Jeruzalemi për në Jeriko dhe ra në duart e kusarëve, të cilët, mbasi e zhveshën dhe e bënë gjithë plagë, u larguan dhe e lanë gati të vdekur. Rastësisht një prift po zbriste nëpër të njëjtën rrugë dhe, mbasi e pa atë burrë, vazhdoi tutje, në anën tjetër. Po ashtu edhe një levit, kur arriti aty, erdhi dhe e pa dhe vazhdoi tutje, në anën tjetër. Por një samaritan, që po udhëtonte i kaloi afër, e pa dhe kishte dhembshuri. Dhe mbasi iu afrua, ia lidhi plagët duke ia larë me vaj dhe me verë; pastaj e vuri mbi kafshën e vet, e çoi në një han dhe u kujdesua për të. . . . Cili nga këta të tre, pra, të duket se që i afërmi i atij që ra në duart e kusarëve?” (Luka 10:30-36).

Ju e dini përgjigjen - samaritani i mirë, njeriu me kombësi të përzier që përçmohej nga hebrenjtë. Samaritani ishte trajtuar keq nga populli i njeriut të plagosur, megjithatë ai i kapërceu barrierat shoqërore për ta ndihmuar këtë nevojtar që i doli përpara.

Këtë do edhe Jezusi që ju të bëni, të përmbushni nevojat që Ai vendos në rrugën tuaj pavarësisht pengesave të dukshme. S'është nevoja të shikoni larg, por ndonjëherë duhet t'i mbani sytë hapur për ata që janë në nevojë. Lëndimi i njerëzve nuk shoqërohet gjithmonë me plagë të dukshme. Nëse një person ka plagë të brendshme emocionale, ai ose ajo mund të jenë të aftë që t'i fshehin mirë ose ndoshta mund të kenë përvetësuar disa mënyra për t'i maskuar. Sjelljet fyese që ju drejtohen ose që jua bëjnë të vështirë të qëndroni pranë dikujt, mund të jenë një thirrje e fshehur për ndihmë.

Megjithatë, edhe nëse dikush ju trajton keq qëllimisht, njësoj si Samaritani, edhe ju keni detyrimin për të shërbyer. Jezusi tha:

“Ju keni dëgjuar se qe thënë: “Duaje të afërmin tënd dhe urreje armikun tënd”. Por unë po ju them: “Duani armiqtë tuaj, bekoni ata që ju mallkojnë, u bëni të mirë atyre që ju keqtrajtojnë dhe ju përndjekin, për të qenë bij të Atit tuaj, që është në qiej, sepse ai bën të lindë diellin e tij mbi të mirët dhe mbi të këqijtë, dhe bën të bjerë shi mbi të drejtët dhe të padrejtët. Sepse po të doni vetëm ata që ju duan, çfarë shpërblimi do të keni? A nuk

bëjnë kështu edhe tagrambledhësit?” (Mateu 5:43-46).

Është shumë e lehtë të jesh i sjellshëm me ata që janë të sjellshëm. Nëse keni bërë ndonjëherë diçka të këndshme për njerëz që në këmbim ju kanë hedhur vetëm vështrime të akullta, ju kanë thumbuar me arrogancë ose janë treguar mosmirënjohës ndaj jush, ju e dini shumë mirë se sa shkurajuese janë reagime të tilla. Gjëja e fundit që doni të bëni është të mendoni se si mund t’i ndihmoni sërish, megjithatë ky është qëndrimi që Jezusi dëshiron që ju të mbani. Interesat e të tjerëve duhet të jenë parësorë për ju, pavarësisht mënyrës se si ata sillen me ju (Filipianëve 2:3-5).

SHIKOHU NË PASQYRË

Para se t’ju falni dashuri të tjerëve, ju duhet të mësoni të doni veten në mënyrën e duhur. Mënyra se si i trajtoni të tjerët varet në një masë të madhe nga mënyra se sa e doni veten tuaj. Kjo nuk është një nga ato frazat që të bëjnë të ndihesh mirë, shkëputur nga ndonjë libër popullor psikologjie. Kthehuni edhe një herë tek Mateu 22:39: “Dhe [urdhërimi] i dyti, i ngjashëm me këtë, është: “DUAJE TË AFËRMIN TËND PORSI VETVETEN””.

Jezusi na mëson t’i trajtojmë të tjerët me të njëjtin respekt dhe kujdes që tregojmë për veten. Nëse ju keni një vetëvlerësim të ulët dhe e nënvlerësoni veten para syve

të Perëndisë ose ndiheni të paralizuar nga ndjenja e pamjaftueshmërisë, atëherë ju nuk jeni gati për të arritur të tjerët. Ju vetë jeni nevojtar dhe bisedat me të tjerët shpesh kthehen në përpjekje për të mbushur boshllëqet tuaja në vend që të ishte e kundërta. Ndoshta, edhe pa qenë të vetëdijshëm, ju rrezikoni të shndërroheni në “konsumues”.

Kura më e mirë për ata që kanë vetëvlerësim të ulët, temë që nuk mund të trajtohet me hollësi këtu, është t'i ushqeni mendimet tuaja me të vërtetat rreth vlerësimit që Jezusi ka për ju. Gjenerali vargje në Bibël që riafirmojnë vlerën tuaj në sytë e Tij dhe mësojini përmendësh (Psalmi 139, Mateu 10:29-31 dhe 1 Samuelit 16:7 janë një fillim i mirë). Ndjenjat e turpit, inferioritetit ose padobishmërisë nuk mund të qëndrojnë mbi Shkrimin dhe me kalimin e kohës mendimet tuaja do të transformohen dhe do të bëhen të reja.

Të duash të tjerët nuk është aspak e lehtë dhe askush nuk e di këtë më mirë se Jezusi. Ai madje ju paralajmëron se gjatë rrugës do të hasni edhe grindje e mëri (Gjoni 15:20-21). Ai mori më shumë sharje të pamerituara se kushdo që ka vuajtur apo do të vuajë ndonjëherë dhe Ai është me ju gjatë gjithë kohës për t'ju mbushur shpirtin me forcën dhe këmbënguljen e Tij (Mateu 28:20). Ju nuk mund të doni nga vetja dhe, nëse përpiqeni ta bëni, kjo do të ishte një rrugë

e sigurt drejt shkretëtirës frymërore dhe kapitjes emocionale.

Lejojeni Zotin të derdhë dashurinë e Tij përmes jush. Duke u shndërruar në enë në duart e Tij, ju çlirohemi nga barra të panumërta stresuese që Ai nuk i ka pasur kurrë në plan që ju t'i mbani.

PROFILI I DJALIT PLANGPRISHËS

Shëmbëlltyra e Jezusit për Djalin Plangprishës që u kthye në shtëpi tek i ati që e priste na jep një pamje të qartë të mënyrës se si vepron dashuria e Perëndisë në dhe përmes jetës tonë. Më i riu ndër djemtë e çoi dëm pasurinë e të atit. Pasi kërkoi pjesën që i takonte, u largua nga qyteti për të jetuar si i donte qejfi. Kur i mbaruan paratë, po ashtu edhe të ashtuqajturve miq të tij, ai u bë i varfër dhe mbeti vetëm.

Ky djalë hebre që dikur kishte qenë i pasur tani ruante derrat për të fituar bukën e gojës, në prag të të vdekurit nga uria dhe duke pyetur veten nëse i ati do ta pranonte të punonte si shërbëtor. Lexoni çfarë ndodhi kur ai vendosi të kthehej në shtëpi:

“U çua, pra, dhe shkoi tek i ati. Por kur ishte ende larg, i ati e pa dhe dhembshuri; u lëshua vrap, ra mbi qafën e tij dhe puthi. Dhe i biri i tha: “O atë, mëkatova kundër qiellit dhe para teje dhe nuk jam më i denjë të quhem biri yt”. Por i ati u tha shërbëtorëve të vet: “Sillni këtu rrobën më

të bukur dhe visheni, i vini një unazë në gisht dhe sandale në këmbë. Nxirrni jashtë viçin e majmur dhe therreni; të hamë dhe të gëzohemi, sepse ky biri im kishte vdekur dhe u kthye në jetë, kishte humbur dhe u gjet përsëri” (Luka 15:20-24).

Kjo skenë prekëse zbulon tre cilësi të dashurisë së qëndrueshme, të modeluara pas pranimit të pakushtëzuar të Perëndisë.

Së pari, dashuria nuk është ndjenjë apo emocion kalimtar, por angazhim. Nëse i ati do i linte ndjenjat e momentit të shpërthenin, ai mund të kishte reaguuar si një njeri i prekur ose i zemëruar. Ulje-ngritjet e shkaktuara nga pritja sigurisht që ia kishin rënduar shpirtin, por dashuria e tij nuk bazohej në faktin nëse ishte apo jo me humor të mirë atë ditë. Angazhimi i tij si baba ishte përcaktues për veprimet dhe reagimin e tij plot dhembshuri.

Së dyti, dashuria është afirmim i përkatësisë, aftësisë dhe vlerës. Djali me shumë gjasa është tronditur kur ndjeu përqaftimin e fortë të të atit që kishte mbështjellë trupin e tij të palarë. Puna me derrat nuk të bën shumë tërheqës, por pamja e tij nuk e ndaloi të atin, që po i dilte zemra vendit nga gëzimi, ta përqaftonte. Ai donte që i biri ta dinte sa i veçantë, i çmuar dhe i pazëvendësueshëm ishte. Dashuria e vërtetë thotë: “Këtu e ke gjithmonë një vend”.

Së treti, dashuria tregon kujdes gjithmonë, edhe kur refuzohet ose hidhet poshtë. Ky

baba e donte të birin njësoj si në çastin kur doli nga pragu i derës, ashtu edhe kur u kthye sërish. Ai nuk i konsideroi si vite të shkuara dëm vitet e dashurisë që i fali ndërsa e rriste; edhe sikur i biri të mos kthehej kurrë, dashuria e tij nuk do të mpakej.

Arrini ta bëni sërish lidhjen midis dashurisë që zgjat dhe dashurisë agape të Perëndisë? Në fakt, në këtë shëmbëlltëri, babai përfaqëson Perëndinë, të cilin mund ta thërrisni Atë, Atin tuaj personal (Romakëve 8:15; Galatasve 4:6). Askush, pra, nuk mund të falë dashuri nga vetja në këtë mënyrë. Në fund, durimi juaj njerëzor do të sosej, sidomos përballë keqtrajtimit. Për këtë arsye, ju duhet të mbështeteni tek Fryma e Shenjtë që të derdhë dashurinë e Perëndisë përmes jush. Ai bën të mundur që ju të shkoni përtej asaj që doni apo dëshironi duke kërkuar më të mirën për të tjerët.

FUQIA E DASHURISË

Asnjë fuqi tjetër në tokë nuk e ka potencialin e plotë të dashurisë së pastër.

Ajo shkrin edhe mendjen e zemrën më të ngurtë në një mënyrë të tillë që as arsyeja, as fjalët apo ligji nuk mund ta bëjnë dot kurrë. Dashuria mund të depërtojë edhe atje ku gjithçka tjetër nuk ia ka dalë dhe pa dashurinë, çdo përpjekje është e kotë.

Tek 1 Korintasve 13:1-2, Pali shkruan:

“Po të flisja gjuhët e njerëzve dhe të engjëjve, dhe të mos kisha dashuri, do të bëhesha si një bronç që kumbon ose si cimballi që tingëllon. Edhe sikur të kisha dhuntinë e profecisë, edhe të dija të gjitha misteret dhe mbarë shkencën dhe të kisha gjithë besimin sa të luaja nga vendi malet, por të mos kisha dashuri, nuk jam asgjë.”.

Pas këtij përshkrimi, ju ndoshta mendoni se Pali e ka fjalën për dashurinë idealiste në kuptimin e gjerë të fjalës, por në vargjet që pasojnë ai krijon një tablo të mënyrave të shëndosha se si t’i drejtojmë të tjerët tek Ai që do më shumë nga të gjithë – Zoti Jezus Krisht. Pali nuk përpiqet ta përshkruajë forcën e jashtëzakonshme të dashurisë në terma teknikë; ai thjesht na tregon se si është dashuria dhe se si vepron.

Lista e mëposhtme shpalos cilësitë e dashurisë nga vargjet katër deri në tetë të Kapitullit të Dashurisë tek 1 Korintasve 13.

Dashuria është e durueshme. Kjo do të thotë të prisni në radhë edhe pse mund të gjenit mënyrën për t’u futur jashtë radhe; të mos e shfryni inatin mbi arkëtarin e shqetësuar pasi keni pritur në radhë; të merrni kohë për të ndihmuar dikë që ka nevojë për kujdesin tuaj të drejtpërdrejtë. Durimi thotë: “Do të eci me hapin tënd dhe do të përshtatem me orarin tënd”.

Dashuria nuk sillet në mënyrë të pahijshme. Në këtë kategori bëjnë pjesë

rregullat e mirësjelljes. Sot nuk flitet shumë për to, por të qenit i sjellshëm është një mënyrë për të shprehur respekt, pjesë thelbësore e dashurisë. Ju mund të tregoni mirësjellje duke i hapur derën dikujt, duke e ndihmuar me mbajtjen e një çante, duke përcjellë ushqimet në tavolinë, duke mosndërprerë bisedën, duke qenë i vetëpërmbytur, duke u kujdesur për pamjen e jashtme, duke treguar maturi në publik, e kështu me radhë. Mirësjellja thotë: “Unë dua të ndihesh mirë dhe nuk dua të të fyje”.

Dashuria nuk krekoset dhe nuk është arrogante. A e keni kapur ndonjëherë veten duke u mburrur? Kjo ndodh fare pa e kuptuar kur fokusoheni për një kohë të gjatë tek vetja ose jeni duke kërkuar që t’ju rrahin shpatullat. Zoti dëshiron t’ju ndihmojë të kultivoni qëndrimin e shpalosur tek Filipianëve 2:3: “Mos bëni asgjë për rivalitet as për mendjemadhësi, por me përulësi, secili ta çmojë tjetrin më shumë se vetveten.”. Kjo nuk do të thotë që ju t’i lejoni të tjerët t’ju shkelin me këmbë, por ju duhet të përpiqeni për ndërtimin e atyre që ju rrethojnë, edhe nëse askush nuk do t’ju japë lëvdata për këtë.

Kush është thelbi i jetës? Është pikërisht ai që tha Jezusi: marrja e dashurisë së Perëndisë dhe përçimi i saj tek të tjerët. Bëjeni Galatasve 5:6, vargun tuaj personal. E vetmja gjë që ka vlerë është “besimi që vepron me anë dashurie”.

